

Lënda: Kthim përgjigje

**Znj. Fildes Doda**

Në përgjigje të kërkesës tuaj, me nr. 8971 prot, datë 31.10.2023, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në të cilën kërkonte rilloaritjen e shtesës së pensionit, ju sqarojmë se:

Referuar sistemit të pagesave të pensioneve PCAMS, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me Vendim Caktim Pensioni nr. 264, datë 20.10.1990, bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ju ka caktuar pension pleqërie, me 32 vite periudhë sigurimi, me masë fillestare pensioni 527.0 lekë në muaj, me datë fillimi 13.09.1990.

Kjo masë pensioni ka përfituar të gjitha rritjet sipas VKM-ve për indeksimin e pensioneve në vite dhe në zbatim të VKM-së nr. 553, datë 28.09.2023 “Për indeksimin e pensioneve”, pika 1, a), në të cilin është përcaktuar se:

1. *Indeksohen në masën 8.6 për qind:*

a) *pensionet e caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pensioni juaj duke filluar nga data 1.10.2023, pas indeksimit me 8.6%, nga 21,704 lekë në muaj është rritur në 23,571 lekë në muaj.*

Totali i të ardhurave në pensionin tuaj është në masën 24,434 lekë (23, 571 lekë masë pensioni + 2, 151 lekë kompesime = 25,722 lekë në muaj), pasi jeni përfituese e disa kompesimeve në pension, si në vijim:

- Kompesimit të shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike, lëndë djegëse në vlerën 700 lekë.
- Kompesimit nga rritja e çmimit të energjisë elektrike sipas VKM 8, datë 14.01.2015 në vlerën 648 lekë.
- Kompesimit stok sipas VKM 565, në vlerën 640 lekë.

- Kompesimit nga ndryshimi i cmimit të bukës, vajgurit e gazit të lëngshëm në vlerën 150 lekë.
- Kompesimit për veshmbathje në vlerën 13 lekë.

Kompesimet e përfituara mbi masën e pensionit nuk janë objekt i indeksimit sipas VKM-ve “Për indeksimin e pensioneve”.

Për sa më sipër, indeksimi i pensionit tuaj është bërë saktë, konform VKM-së nr. 553, datë 28.09.2023 “Për indeksimin e pensioneve”.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.